



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 23

Tiranë – E premte, 20 shkurt 2015

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 8918, datë 3.2.2015	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 1179
Dekret i Presidentit nr. 8936, datë 9.2.2015	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 1179
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 108, datë 4.2.2015	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2015, miratuar për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për financimin e rikonstruksionit të godinës së re të KQZ-së..... 1179
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 110, datë 4.2.2015	Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG), Agjencisë Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike (ALCIRT), Agjencisë së Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit (AKTI), Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik (AKCE), Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) dhe Agjencisë së Prokurimit Publik (APP) të mjediseve të ndërtesës (godinës) “Ish-INIMA”..... 1180
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 111, datë 6.2.2015	Për një shtesë në vendimin nr. 634, datë 1.10.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat të punëve publike dhe shërbimeve, për ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e rrugëve nacionale”, të ndryshuar..... 1183
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 126, datë 11.2.2015	Për përcaktimin e shumave të shuarjes, me kompensim, të detyrimeve ndërmjet institucioneve buxhetore dhe jobuxhetore që financohen nga buxheti, KESH, sh.a., OSHEE, sh.a., dhe Ministrisë së Financave..... 1184
Vendim i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve nr. 3, datë 19.1.2015	Për disa projekte fituese për infrastrukturën vendore (thirrja e pestë për vitin 2014), si dhe për një ndryshim në vendimin nr.17, datë 19.11.2014, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, “Për shpërndarjen e fondit për infrastrukturën vendore, thirrja e pestë” 1188

Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 5, datë 5.2.2015	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të nenit 18 të ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”.....	1190
Urdhër i Inspektoratit Qendror nr. 58/1, datë 22.1.2015	Për disa shtesa dhe ndryshime në urdhrin nr. 58, datë 21.8.2014 “Për miratimin e formateve standard për dokumentimin e veprimtarisë së inspektimit në Republikën e Shqipërisë”.....	1194
Kërkesë e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës nr. 835, datë 5.2.2015	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Unaza Veriore Korçë”.....	1206
Kërkesë e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës nr. 836, datë 5.2.2015	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Unaza Veriore Korçë”.....	1207
Kërkesë e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës nr. 837, datë 5.2.2015	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Levan- Vlorë (shtesat)”.....	1207
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Naxhi Çaça.....	1208
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Ilir Hasantari.....	1208
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Dedë Mhill Logu.....	1208

**DEKRET****Nr. 8918, datë 3.2.2015****PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 e 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Ana Jani Golemi
2. Elion Fatmir Hoxha
3. Alma Jazo Kulgin (Xhaferaj)
4. Gladiola Demë Klarmann (Buçpapaj)
5. Amadeos Rifan Rexha
6. Edvina Skënder Qelibari
7. Miranda Bashkim Hoffmann (Keta)
8. Loreta Agron Jakubowski (Zani)
9. Mirgea Guri Dushollari (Nune)
10. Morava Basri Tota
11. Dritan Todi Kulari
12. Gentjana Gjovalin Hasani
13. Elda Ruzhdi Reçi
14. Nadja Fisnik Haçkaj
15. Nevisa Teme Çaushaj
16. Majlinda Ali Stralucke (Kala)
17. Arbër Kujtim Gjoka
18. Altin Xhemali Braneshi
19. Paola Altin Braneshi
20. Joel Altin Braneshi
21. Valentina Lulëzim Bregasi (Shaulla)
22. Medi Ismet Bregasi
23. Adriatik Agim Toska
24. Edlira Reis Toska (Caka)
25. Alba Adriatik Toska
26. Enia Adriatik Toska
27. David Adriatik Toska
28. Lovernia Agron Dehnert (Çobanaj)
29. Esmeralda Sigurim Qato (Ruçi)
30. Aron Anri Qato
31. Eduart Sami Kryeziu
32. Armando Kujtim Hoxha
33. Fatjona Shkëlqim Kaçi
34. Aleksandër Skënder Reçi

35. Ilir Jonuz Merxhani
36. Daklea Jusuf Tançica
37. Blerian Shpëtim Kushta

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË
Bujar Nishani

DEKRET**Nr. 8936, datë 9.2.2015****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të nenit 9, pika 7 e nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimet e ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe ministrit të Jashtëm,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Fidan Mehdi Gashi
2. Mërgim (Mergim) Hamdi Vojvoda
3. Fjolla Xhaudet Cakuli

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË
Bujar Nishani

VENDIM**Nr. 108, datë 4.2.2015****PËR NJË SHITESË FONDI NË
BUXHETIN E VITIT 2015, MIRATUAR
PËR KOMISIONIN QENDROR TË
ZGJEDHJEVE, PËR FINANCIMIN E
RIKONSTRUKSIONIT TË GODINËS SË
RE TË KQZ-SË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”,



dhe të ligjit nr. 160, datë 27.11.2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në buxhetin e miratuar për vitin 2015, t’i shtohet fondi prej 57 937 000 (pesëdhjetë e shtatë milionë e nëntëqind e tridhjetë e shtatë mijë) lekësh, për mbulimin e shpenzimeve të rikonstruksionit të godinës së re të KQZ-së.

2. Fondi prej 57 937 000 (pesëdhjetë e shtatë milionë e nëntëqind e tridhjetë e shtatë mijë) lekësh do të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit për vitin 2015.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 110, datë 4.2.2015

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI TË AUTORITETIT
SHTETËROR PËR INFORMACIONIN
GJEOPAPËSINOR (ASIG), AGJENCISË
KOMBËTARE PËR SIGURINË
KOMPJUTERIKE (ALCIRT), AGJENCISË
SË KËRKIMIT, TEKNOLOGJISË DHE
INOACIONIT (AKTI), AUTORITETIT
KOMBËTAR PËR CERTIFIKIMIN
ELEKTRONIK (AKCE), AGJENCISË
KOMBËTARE TË SHOQËRISË SË
INFORMACIONIT (AKSHI) DHE
AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK
(APP) TË MJEDISEVE TË NDËRTESËS
(GODINËS) “ISH-INIMA”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13, 15 e 16, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, të mjedisve të ndërtesës (godinës) “Ish-INIMA”, me numër pasurie 1/12, zona kadastrale 8160, rruga “Papa Gjon Pali”, nr. 3, të Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG), Agjencisë Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike (ALCIRT), Agjencisë së Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit (AKTI) dhe Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik (AKCE), sipas planimetrive bashkëlidhur këtij vendimi, për mjedise pune për ushtrimin e veprimtarisë administrative të këtyre institucioneve, si më poshtë vijon:

a) Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik (AKCE) dhe Agjencisë së Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit (AKTI) u kalojnë në përgjegjësi administrimi mjediset me sipërfaqe prej 683 m², të zyrave të katit të parë të godinës, sipas planimetrisë aneksi 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

b) Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG) dhe Agjencisë Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike (ALCIRT) u kalojnë në përgjegjësi administrimi mjediset me sipërfaqe prej 700 m², të zyrave të katit të dytë të godinës, sipas planimetrisë aneksi 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Kalimin në përgjegjësi administrimi të Agjencisë Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit (AKSHI) dhe Agjencisë së Prokurimit Publik (APP) të mjedisve të ndërtesës (godinës) “Ish-INIMA”, me numër pasurie 1/12, zona kadastrale 8160, rruga “Papa Gjon Pali”, nr. 3, sipas planimetrive bashkëlidhur këtij vendimi, për mjedise pune për ushtrimin e veprimtarisë administrative të këtyre institucioneve, si më poshtë vijon:

a) Agjencisë së Prokurimit Publik (APP) i kalojnë në përgjegjësi administrimi mjediset me sipërfaqe prej 900 m², të zyrave të katit të dytë, sipas planimetrisë Aneksi 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

b) Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) i kalojnë në përgjegjësi administrimi mjediset me sipërfaqe prej 454.2 m², të zyrave të katit të parë të godinës, sipas planimetrisë Aneksi 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.



3. Këtyre institucioneve u ndalohej ta ndryshojnë destinacionin e pronës, të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojnë atë ose t'ua japin në përdorim të tretëve.

4. Vendimi nr. 560, datë 16.8.2006, i Këshillit të Ministrave, “Për kalimin e disa mjediseve në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Integritetit për ushtrimin e veprimtarisë”, të ndryshuar, vendimi nr. 324, datë 30.5.2007, i Këshillit të Ministrave, “Për dhënien në përdorim Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës të disa mjediseve të ndërtesës (godinës) “Ish-INIMA””, vendimi nr. 153, datë 11.2.2009, i Këshillit të Ministrave, “Për dhënien në përdorim Qendrës Kombëtare të Licencimit të disa mjediseve në ndërtesën (godinën) e INIMA””, shfuqizohen.

5. Ngarkohet ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave të marrin masat përkatëse për ndarjen dhe organizimin e agjencive të përmendura në pikat 1 dhe 2, të këtij vendimi, në mjediset e godinës.

6. Ngarkohen Kryeministria, ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe kryeregjistruesi i Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

ANEKSI 1



Sipërfaqja e Qendres Kombetare te Lincimit
eshte 900 m2



Nr. i Zyres	Sipërfaqja në m ²
1	65.920 m ²
2	20.329 m ²
3	17.462 m ²
4	58.238 m ²
5	10.398 m ²
6	20.817 m ²
7	21.140 m ²
8	21.529 m ²
9	21.515 m ²
10	20.968 m ²
11	20.926 m ²
12	15.203 m ²
13	25.723 m ²
14	13.142 m ²
15	26.318 m ²
16	9.357 m ²
17	10.832 m ²
18	3.428 m ²
19	3 m ²
20	46.069 m ²



ANEKSI 2



Sipërfaqja në përdorim QKR është 454.2 m².




Zyra	Punonjës	
1	1	1
2	1	1
3	1	1
4	4	4
5	9	9
6	9	9
7	1	1
8	4	4
9	2	2
10	2	2
11	5	5
Sportelet	11	11

ANEKSI 3




Pjesa veri lindore e godinës. Kati i parë i ambienteve ka një sipërfaqe totale prej: $S = 683.555 \text{ m}^2$



Nr. i Zyres	Sipërfaqja në m ²
1	14.445 m ²
2	23.101 m ²
3	6.312 m ²
4	77.793 m ²
5	23.169 m ²
6	22.816 m ²
7	22.554 m ²
8	22.601 m ²
9	22.776 m ²
10	22.885 m ²
11	31.955 m ²
12	14.862 m ²
13	10.484 m ²
14	10.395 m ²
15	13.524 m ²
16	13.413 m ²
17	68.765 m ²
18	17.680 m ²

ANEKSI 4

Kati i dytë i ambienteve ka sipërfaqe të
përgjithshme $S = 700.921 \text{ m}^2$



Nr. i Zyres	Sipërfaqja në m ²
1	14.445 m ²
2	23.101 m ²
3	32.179 m ²
4	10.712 m ²
5	23.169 m ²
6	22.816 m ²
7	22.554 m ²
8	22.601 m ²
9	22.776 m ²
10	22.885 m ²
11	31.955 m ²
12	14.862 m ²
13	12.015 m ²
14	12.015 m ²
15	11.559 m ²
16	11.559 m ²
17	23.392 m ²
18	22.676 m ²
19	22.793 m ²
20	14.383 m ²
21	4.780 m ²

VENDIM

Nr. 111, datë 6.2.2015

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 634, DATË 1.10.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR VLERËSIMIN DHE DHËNIEN ME KONCESION /PARTNERITET PUBLIK PRIVAT TË PUNËVE PUBLIKE DHE SHËRBIMEVE, PËR NDËRTIMIN, OPERIMIN, MIRËMBAJTJEN DHE REHABILITIMIN E RRUGËVE NACIONALE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pikat 1, shkronja “j”, dhe 2, e 49, të ligjit 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në tekstin e rregullave për vlerësimin dhe dhënie me koncesion/partneritet publik privat të punëve publike dhe shërbimeve për ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e rrugëve

nacionale, të miratuar me vendimin nr. 634, datë 1.10.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, pas nenit 28 shtohet neni 28/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 28/1

Përmbushja e kriterëve të parakualifikimit nëpërmjet një bashkëpunëtori

1. Ofertuesi (ose nëse ofertuesi është një konsorcium apo anëtar konsorciumi) mund të zgjedhë të paraqesë prova (përfshirë pasqyrat financiare) nga një bashkëpunëtor, me qëllim përmbushjen e kushteve financiare.

2. Ofertuesi (ose nëse ofertuesi është një konsorcium apo anëtar konsorciumi) mund të zgjedhë të paraqesë provat e punimeve dhe shërbimeve nga një bashkëpunëtor, me qëllim përmbushjen e kriterëve teknike.

3. Për qëllimet e këtij dokumenti parakualifikimi, “Bashkëpunëtor”, nënkupton çdo subjekt që e kontrollon në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, kontrollohet nga/ose është nën kontroll të përbashkët me ofertuesin; “kontroll”, është pushteti për të zgjedhur shumicën e bordit të drejtorëve (ose organe përbërëse të ngjashme) ose autoriteti për të drejtuar në mënyrë të



drejtpërdrejtë apo të tërthortë menaxhimin dhe politikat e një enti, nëpërmjet zotërimit të shumicës së letrave me vlerë, me kontratë, ndërsa “duke kontrolluar” dhe “i kontrolluar” kanë kuptime të lidhura reciprokisht.

4. Nëse ndonjë kriter kualifikimi, teknik apo financiar, është zbatuar nga ana e ndonjë subjekti që është bashkëpunëtor i ofertuesit, ofertuesi, në këtë rast, duhet të paraqesë dokumente që vërtetojnë se një subjekt i tillë përmbush kushtet e bashkëpunëtorit, siç edhe është parashikuar më lart.

5. Për qëllimet e mësipërme, bashkëpunëtori, duhet të paraqesë një letër ku të marrë përsipër se do të vërë në dispozicion të ofertuesit të gjitha burimet e nevojshme.”

6. Ngarkohet Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 126, datë 11.2.2015

PËR PËRCAKTIMIN E SHUMAVE TË SHUARJES, ME KOMPENSIM, TË DETYRIMEVE NDËRMJET INSTITUCIONEVE BUXHETORE DHE JOBUXHETORE QË FINANCOHEN NGA BUXHETI, KESH, SHA, OSHEE, SHA, DHE MINISTRISË SË FINANCIVE

Në zbatim të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7, të ligjit nr. 8485, datë 12. 5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative”, të ndryshuar, dhe të nenit 514 e në vijim, të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë dhe të ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e shuarjes, me kompensim, të detyrimeve të krijuara, të njohura dhe rakorduar mes palëve, sipas përcaktimeve të mëposhtme:

a) Institucionet buxhetore dhe institucionet që financohen nga buxheti, të përcaktuara në aneksin nr.1, të këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij, kanë rakorduar detyrimet e energjisë elektrike, në kolonën “total debi e pranuar”, të krijuara deri më

31.12.2014. Këto detyrime ndaj shoqërisë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) sh.a., të shuhën deri në vlerën 9 000 000 000 (nëntë miliardë) lekë. OSHEE, sh.a.-ja, në cilësinë e kreditorit, jep pëlqimin për këtë shuarje.

b) Detyrimet e krijuara deri më 31.12.2014, të OSHEE, sh.a.-së, ndaj KESH, sh.a.-së, për energjinë e lëvruar nga KESH, sh.a.-ja, për furnizimin e konsumatorëve tariforë, të përfshira në aktrakordin e paraqitur në aneksin nr.2, të këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij, të shuhën deri në vlerën 9 000 000 000 (nëntë miliardë) lekë.

c) Detyrimet e krijuara deri më 31.12.2014, të KESH, sh.a.-së, ndaj Ministrisë së Financave, për huatë e marra nga KESH, sh.a.-ja, për të cilat Ministria e Financave ka hyrë në marrëdhënie nënhuazimi, garancie shtetërore apo kredidhënieje, të përfshira në aktrakordin e paraqitur në aneksin nr.3, të këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij, të shuhën deri në vlerën 9 000 000 000 (nëntë miliardë) lekë.

2. Ky vendim dhe akti i akordimit, i nënshkruar ndërmjet palëve, përbëjnë dokumentacionin bazë financiar për kryerjen e veprimeve kontabël dhe mbylljen e llogarive të pagueshme (kreditorët) apo të arkëtueshme (debitorët).

3. Pas përfundimit të veprimeve kontabël, të gjitha institucionet e varësishë njoftojnë titullarët e tyre për shumën e detyrimit të shuar dhe mbylljen e llogarive.

4. Titullarët e ministrive/institucioneve qendrore, që kanë në varësi institucionet e përfshira në aneksin nr.1, njoftojnë Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë dhe Ministrinë e Financave për shumën e detyrimit të shuar për çdo institucion varësie. Bashkitë dhe komunat njoftojnë ministrin e Shtetit për Çështjet Vendore, Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë dhe Ministrinë e Financave për shumën e detyrimit të shuar për çdo institucion varësie.

5. OSHEE, sh.a.-ja, dhe KESH, sh.a.-ja, njoftojnë Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë dhe Ministrinë e Financave për shumën e detyrimit të shuar dhe mbylljen e llogarive.

6. Ngarkohen të gjitha institucionet e përfshira në këtë vendim për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



Aneksi nr. 1
Përmbledhëse e Detyrimeve të Prapambetura të Pranuara nga Institucionet

**LISTA E DETYRIMEVE TE KONTRATAVE BUXHETORE DHE JOBUXHETORE
PER PERIUDHEN JANAR 2007 DERI NE DHJETOR 2014 SIPAS SISTEMIT TE FATURIMIT DATE 31.12.2014**

KATEGORI	NRKONTRATE	Principal	Kamatevonese	Total Detyrim
Bashki	727	135,641,159	133,923,920	269,565,079
Borde Kullimi	48	41,691,902	130,781,573	172,473,476
Burgje	18	8,435,052	43,323,558	51,758,610
Cerdhe	88	6,558,015	7,901,861	14,459,876
Komisariate	134	23,940,251	28,186,823	52,127,074
Komuna	619	87,313,253	83,523,559	170,836,812
Konvikte	49	8,507,346	9,621,955	18,129,301
Kopshte	361	14,454,264	21,180,961	35,635,225
QST	43	98,407,460	81,199,149	179,606,608
Reparte	227	50,258,680	49,814,187	100,072,868
Shkolla	1847	152,374,064	149,050,000	301,424,064
Spitale	1281	160,793,981	212,196,779	372,990,760
Ujesjelles-pompa	1017	3,011,418,593	3,249,501,656	6,260,920,248
Grand Total	6,459	3,799,794,020	4,200,205,981	8,000,000,000

Aneksi nr. 2


 Kompania e Energji Elektrike Shqiptare
1346 / dt. 18.02.2015


 OPERATORI I SHPERNDARJES
 SE ENERGJISE ELEKTRIKE
3787 / 18.02.2015

**AKT-RAKORDIM
I DETYRIMEVE TE OSHEE SH.A. NDAJ KESH SH.A.**

Në zbatim të objektivit për rakordimin e detyrimeve të ndërsjellta ndërmjet KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a., si dhe në kuadrin e procesit të realizimit të detyrave të strategjisë së qeverisë për zgjidhjen dhe pagesën e borxheve në sektorin e energjisë dhe konkretisht në kuadrin procesit që po ndërmerret për miratimin e akteve rregulluese për shuarjen me kompensim të detyrimeve të ndërsjellta në sektorin e energjisë elektrike, ndërmjet institucioneve buxhetore dhe jo buxhetore, OSHEE sh.a., KESH sh.a. dhe Ministrisë së Financave, për një shumë vëri në 8 miliardë lekë, shumën e detyrimeve të OSHEE sh.a. ndaj KESH sh.a. që do të jenë pjesë e procesit në fjalë është si më poshtë:

Nr.	Detajet e Faturës	Vlera (Lek)
1	Fatura nr.62 datë 18 Prill 2011	692,131,756
2	Fatura nr.242 datë 14 Dhjetor 2011	372,813,396
3	Fatura nr.260 datë 08 Dhjetor 2012	6,535,054,848
	Totali	8,000,000,000

Ky Akt-Rakordimi nënshkruhet në 4 (katër) kopje, 2 (dy) kopje secila palë.

Subjekti:
Emri Mbiemri:
Firma:
Pozicioni:
Data:

KESH sh.a.
Agron HETOIA

Administratori
/02/2015

OSHEE sh.a.
Adrian CELA
Prodhues
Administratori
/02/2015



Aneksi Nr. 3

AKT- RAKORDIMI

Bazuar në VKM Nr..... datë.....”Për përcaktimin e shuarjes me kompesim të detyrimeve ndërmjet institucioneve buxhetorë dhe jobuxhetorë që financohen nga buxheti, KESH sh.a., OSHEE sh.a. dhe Ministrisë së Financave”, mbahet sot ky Akt Rakordimi ndërmjet Ministrisë së Financave dhe KESH sh.a. për shuarjen e detyrimeve të mëposhtëme:

1. Detyrimet e KESH sh.a.ndaj Ministrisë së Financave që rrjedhin nga marrëveshjet e nënhuave deri në datën 31.12.2014 janë:

Nr.	Projekti	Monedha	Detyrimi për Interesa	Detyrimi për principale	Detyrimi Total	Detyrimi Total në EUR	Detyrimi total në LEKË
1	WB-IDA Sig.Digave	EUR	66,265.41	0.00	66,265.41	66,265.41	9,286,434.56
2	IBRD -Sigurimi Digave	EUR	1,242.35	0.00	1,242.35	1,242.35	174,102.93
3	EBRD - Përmirsimi Sig.Digave	EUR	103,122.00	0.00	103,122.00	103,122.00	14,451,517.08
4	BB - IDA - Trans Shpërndarje nr.2826	USD	74,375.48	1,552,279.32	1,626,654.80	1,337,515.58	187,439,432.60
5	BB - IDA - Rehab.&Ristr.Sek.En.Nr.36710	USD	294,803.60	2,300,976.14	2,595,779.74	2,134,377.76	299,111,699.44
6	BB - IDA - Zv.humbjeve Nr.2677	USD	14,378.44	330,926.00	345,304.44	283,926.29	39,789,430.62
7	BKT - Rehab.rrjetit elektrik (8,6 mld ITL)	EUR	32,302.32	403,780.00	436,082.32	436,082.32	61,112,576.32
8	M.Cr.Centralee-Ndimë në Sek.Energjitik "Mars 2000"	EUR	28,395.40	0.00	28,395.40	28,395.40	3,979,331.36
9	M.Cr.Centrale -Ristr.&Menaxhimi KESH (ITCS)	EUR	96,681.16	0.00	96,681.16	96,681.16	13,548,897.76
10	KFW-Gjermani-Comm.-Korca	EUR	33,254.43	169,748.90	203,003.33	203,003.33	28,448,886.67
11	KFW-Gjermani BiSaBu TR.I	EUR	132,332.11	668,013.16	800,345.27	800,345.49	112,161,787.54
12	KFW-Gjermani BiSaBu TR.II	EUR	198,297.84	1,177,199.02	1,375,496.86	1,375,496.86	192,762,129.96
13	BB - IDA -Projekti TEC Vlorë Nr. 38720	USD	301,590.01	1,666,666.66	1,968,256.67	1,618,397.43	226,802,216.08
14	ICO-Spanjë	USD	28,301.08	0.00	28,301.08	23,270.54	3,261,133.45
Totali						8,508,121.92	1,192,329,576.37



2. Detyrimet e KESH sh.a.ndaj Ministrisë së Financave që rrjedhin nga marrëveshjet me Garanci Shtetërore deri në datën 31.12.2014 janë:

Nr.	Projekti	Monedha	Detyrimi për Interesa	Detyrimi për principale	Detyrimi Total	Detyrimi Total në EUR	Detyrimi total në LEKË
1	JICA-Loan Japan (ABA-P1)	YEN	65,594,921.00	210,125,000.00	275,719,921.00	2,119,610.91	297,042,272.93
2	Export-Import Bank of Korea (EDCF)	EUR	1,293,972.00	0.00	1,293,972.00	1,293,972.00	181,337,236.08
3	EBRD (Nr.23830)	EUR	143,136.53	6,092,338.57	6,235,475.10	6,235,475.10	873,839,480.51
4	EBRD (Nr.33833) - Vlora Thermo Plant	EUR	1,294,838.88	10,162,629.07	11,457,467.95	11,457,467.95	1,605,649,558.51
5	EIB (Nr.21264)	EUR	3,011,967.91	6,306,730.83	9,318,698.74	9,318,698.74	1,305,922,441.42
6	EIB (Nr.22706)	EUR	3,525,241.24	5,210,866.90	8,736,108.14	8,736,108.14	1,224,278,194.74
7	JICA-Loan Japan (ABA-P2)	YEN	116,142,688.06	373,810,742.40	489,953,430.46	3,913,713.46	548,467,804.28
8	EBRD (Nr.36112) - ECSEE TSO Project	EUR	266,365.40	1,570,608.00	1,836,973.40	1,836,973.40	257,433,459.28
9	KfW-Linja 400kV Tirane - Podgorice	EUR	292,930.71	1,783,075.11	2,076,005.82	2,076,005.82	290,931,458.42
10	M.Cr.Centrale Comm.AID98	EUR	85,252.23	418,401.25	503,653.48	503,653.48	70,581,991.13
Totali						47,491,679.00	6,655,483,897.31

3. Detyrimi për financimin buxhetor deri në 31.12.2014 është :

Përshkrimi	Data e nënshkrimit	Teprica kredisë(Lekë)
		31.12.2014
Hua nga Buxheti Shtetit	16.02.2012	148,108,530.00
Interesa të llogaritura		277,703.49
Kamat vonesa të llogaritura		3,800,292.83
Totali		152,186,526.32

Gjithsej shuma e detyrimeve për priudhën deri në 31.12.2014:

Përshkrimi	Total detyrimi në Lekë
Për Marrëveshjet Nënhuave	1,192,329,576.37
Për Marrëveshjet me Garanci Shtetërore	6,655,483,897.31
Për financimin buxhetor	152,186,526.32
	8,000,000,000.00

Palët, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar, nënshkruajnë këtë Akt Rakordim në dy kopjë Origjinale.

Për Ministrinë e Financave

Gelardina PRODANI

Për Korporatën Elektroenergjetike Shqiptare sh.a.

Agron HETOJA

SEKRETARE E PËRGJITHSHME



ADMINISTRATORI



**VENDIM****Nr. 3, datë 19.1.2015**

**PËR DISA PROJEKTE FITUESE PËR
INFRASTRUKTURËN VENDORE
(THIRRJA E PESTË PËR VITIN 2014), SI
DHE PËR NJË NDRYSHIM NË
VENDIMIN NR.17, DATË 19.11.2014, TË
KOMITETIT PËR ZHVILLIMIN E
RAJONEVE, “PËR SHPËRNDARJEN E
FONDIT PËR INFRASTRUKTURËN
VENDORE, THIRRJA E PESTË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 e të aneksit 3, të ligjit nr.160, datë 27.11.2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Shpërndarjen e fondeve për projekte të infrastrukturës vendore, në vlerën 270 800 000 (dyqind e shtatëdhjetë milionë e tetëqind mijë) lekë, pjesë e thirrjes së pestë, shpallur në vendimin nr. 16, datë 10.10.2014, pjesë e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2014, sipas tabelës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Në tabelën nr. 1, që i bashkëlidhej vendimit nr. 17, datë 19.11.2014, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, “Për shpërndarjen e fondit për infrastrukturën vendore, thirrja e pestë”, bëhen ndryshime sipas tabelës 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Autoritetet kontraktuese, për projektet sipas pikave 1 dhe 2, të këtij vendimi, duhet të kryejnë procedurat e prokurimit publik dhe të lidhjes së kontratës përkatëse për zbatimin e punimeve të ndërtimit deri në fillim të tremujorit të dytë të vitit 2015. Për fondet e projekteve të paprokuruar sipas këtij afati, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve ka të drejtën për të

rishqyrtuar financimin dhe rialokimin e fondeve të këtij financimi për një projekt tjetër.

4. Ngarkohet sekretariati teknik pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit të bëjë monitorimin dhe raportimin e ecurisë së zbatimit të projekteve pranë Njesisë së Bashkërendimit të Programeve Zhvillimore dhe Planifikimit Strategjik, pjesë e Departamentit të Programimit të Zhvillimit të Financimeve dhe Ndihmës së Huaj, sipas kalendarit të paraqitur nga NQV-të, në përputhje me pikën 3, të këtij vendimi.

5. Ngarkohen ministri i Zhvillimit Urban dhe Turizmit, ministri i Financave dhe Sekretariati i Përgjithshëm i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, në Kryeministri, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI
Edi Rama**

Zëvendëskryeministri	Anëtar;
Ministri i Financave	Anëtar;
Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes	Anëtar;
Ministri i Zhvillimit Urban	Anëtar;
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	Anëtar;
Ministri i Arsimit dhe Sportit	Anëtar;
Ministri i Shëndetësisë	Anëtar;
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	Anëtar;
Ministri i Kulturës	Anëtar;
Ministri i Mjedisit	Anëtar;
Ministri i Punëve të Brendshme	Anëtar;
Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike	Anëtar;
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	Anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë	Anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Komunave të Shqipërisë	Anëtar;
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore	Anëtar;



Tabela 1. Projektet për financim të infrastrukturës vendore, thirrja e pestë

Nr.	Autoriteti kontraktues	Emërtimi i projektit	Vlera e plotë e projektit	Financimi 2015
Qarku Korçë				
1	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Rehabilitimi i bregut të liqenit të Ohrit dhe gjelbërimi përgjatë rrugës segmenti Lin-Pogradec	198,895,706	141,011,968
Qarku Lezhë				
2	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Ndërtimi i këmbëve të urës në fshatin Skuraj, Milot	4,000,000	2,800,000
3	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Sistemim – asfaltim i rrugës së fshatit Malbardhë, Milot	40,000,000	28,000,000
4	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Hartimi i studimeve dhe projekt ideve për projekte komplekse urbane	100,000,000	100,000,000
TOTALI			342,895,706	270,800,000

Shënim:

1. “Vlera e plotë e projektit” përfaqëson vlerën brenda të cilës caktohet fondi limit për prokurimin (kur nuk ka financim tjetër nga NJQV-të).
2. “Vlera e financimit” për vitin 2015 tregon vlerën e financimit që vihet në dispozicion nga buxheti i Fondit për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2015.
3. Diferenca financimit të vlerës së plotë (mbas prokurimit) me vlerën e financimit për vitin 2015, do të financohet nga FZHR për vitin 2016.
4. Detajimi i fondit për projektin 4 (Hartimi i studimeve dhe projekt ideve për projekte komplekse urbane) bëhet me vendim të Këshillit Drejtues të FSHZH
5. Për projektin me nr. 2, ndërtimi i pjesës së trupit të urës do të merret përsipër nga Ministria e Mbrojtjes.

Tabela 2. Ndryshim në tabelën 1, që i bashkëlidhej vendimit nr.17, datë 19.11.2014

Projektit nr.6 i ndryshon autoriteti kontraktues, si edhe vlerat e financimit (duke sjellë ndryshim të vlerës totale), si më poshtë vijon:

Nr.	Autoriteti kontraktues	Emërtimi i projektit	Vlera e plotë projektit (lekë)	Vlera e financimit për vitin 2014 (lekë)
6	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Sistemim asfaltim Rruga nga Bashkia Vlore deri te Spitali	90,000,000	72,000,000



VENDIM

Nr. 5, datë 5.2.2015

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Bashkim Dedja kryetar i Gjykatës Kushtetuese

Vladimir Kristo anëtar i “ “

Sokol Berberi anëtar i “ “

Vitore Tusha anëtare e “ “

Altina Xhoxhaj anëtare e “ “

Fatmir Hoxha anëtar i “ “

Gani Dizdari anëtar i “ “

Fatos Lulo anëtar i “ “

Besnik Imeraj anëtar i “ “

me sekretare Edmira Babaj, në datën 14.10.2014
mori në shqyrtim, mbi bazë dokumentesh, çështjen
nr. 32/4 Akti që u përket:

KËRKUESE: Gjykata e Apelit Tiranë

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Kuvendi i
Republikës së Shqipërisë, Këshilli i Ministrave

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me
Kushtetutën, i nenit 18 të ligjit nr. 9235, datë
29.07.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e
pronës”.

BAZA LIGJORE: Nenet 134/1, shkronja “d”
dhe 145/2 të Kushtetutës së Republikës të
Shqipërisë dhe neni 68 i ligjit nr. 8577, datë
10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e
Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Besnik Imeraj,
shqyrtoi dokumentet e paraqitura dhe diskutoi
çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të
Pronave (KKKP) Qarku Shkodër, me vendimin nr.
1086, datë 29.05.1996, mbi bazën e kërkesës së
bërë nga trashëgimtarët e ish- pronarit Ruzhdi Duli
(Qershizi), midis të tjerash, ka vendosur “*të njohë
pronësinë, në zbatim të nenit 16, të një sipërfaqeje prej 1188
m2 e zënë me rrugë e trotuare.*”

2. Me daljen e ligjit nr. 9235, datë 29.07.2004, i
ndryshuar, paditësit Ruzhdi Duli, Lumniye Lika etj,
i janë drejtuar organit administrativ Zyra Rajonale
e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (ZRKKP)

Shkodër, duke kërkuar ndryshimin pjesërisht të
vendimit nr. 1086, datë 29.05.1996 të KKKP-së
Qarku Shkodër, me pretendimin se një pjesë e
kësaj sipërfaqeje është e lirë, ndaj si e tillë duhet të
kthehet në natyrë. Me vendimin nr. 398, datë
16.10.2008, ZRKKP-ja Shkodër ka vendosur:
“*Rrëzimin e kërkesës me objekt ndryshimin pjesërisht të
vendimit nr. 1086, datë 29.05.1996 të Komisionit të
Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Qarku Shkodër.*”

3. Kundër këtij vendimi nuk është paraqitur
ankim administrativ pranë Agjencisë së Kthimit
dhe Kompensimit të Pronave (AKKP) Tiranë, por
trashëgimtarët e ish-pronarit Duli i janë drejtuar
gjykatës me padi me objekt kërkitimi ndryshimin e
vendimit nr. 1086, datë 29.05.1996 të KKKP-së
Qarku Shkodër.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me
vendimin nr. 771, datë 01.02.2013, ka ndryshuar
pjesërisht vendimin nr. 1086, datë 29.05.1996 të
KKKP-së Qarku Shkodër, në pikën 1 të tij, si dhe
vendimin nr. 398, datë 16.10.2008 të ZRKKP-së
Shkodër, duke vendosur që nga sipërfaqja e
kompensuar prej 1188 m2 të kthehet një pjesë e saj
prej 275 m², me konfiguracion sipas skicës së aktit
të ekspertimit të administruar në gjykim.

5. Ky vendim është ankimuar nga palët e
paditura në proces, AKKP-ja Tiranë dhe
Avokatura e Shtetit, të cilat kanë pretenduar edhe
se pala paditëse në procesin gjyqësor nuk ka
paraqitur ankim në gjykatë ndaj vendimit të organit
administrativ brenda afatit 30-ditor që parashikon
ligji dhe për pasojë padia duhej të rrëzohej si e
parashkruar.

6. Në ligjin nr. 9235, datë 29.07.2004 “Për
kthimin dhe kompensimin e pronës” (ligji nr.
9235/2004), parashikohet kontrolli i ligjshmërisë së
vendimeve të ZRKKP-së si nga organi më i lartë
administrativ, AKKP-ja, ashtu edhe në rrugë
gjyqësore. Më konkretisht, neni 18 i ligjit
parashikon: “*Kundër vendimit të AKKP-së, subjekti i
shpronësuar ose Avokati i Shtetit ka të drejtë të bëjë ankim,
brenda 30 ditëve nga njoftimi i këtij vendimi, pranë
Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, sipas rregullave të
Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.*”

7. Gjykata referuese, gjatë shqyrtimit të ankimit
kundër vendimit nr. 771, datë 01.02.2013 të
Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me
vendimin nr. 3221/845 regj, datë 31.03.2014, ka
vendosur pezullimin e gjykimit të kësaj çështjeje
dhe dërgimin e saj Gjykatës Kushtetuese, në bazë



të nenit 145/2 të Kushtetutës, për kontrollin e pajtueshmërisë me Kushtetutën të nenit 18 të ligjit nr. 9235/2004.

II

8. **Gjykata referuese** në vendimin e saj për pezullimin e çështjes ka parashtruar këto shkaqe për të mbështetur pretendimin e saj për shfuqizimin e normës së kundërshtuar:

8.1 Zbatimi i nenit 18 të ligjit nr. 9235/2004 cenon parimin e sigurisë juridike, për shkak të paqartësisë së normës juridike, por edhe të pranisë së kontradiksionit me normat e tjera ligjore që zbatohen në çështjen e kthimit të pronave.

8.2 Është e njohur për doktrinën dhe jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese domosdoshmëria e formulimit të qartë të normave ligjore. Një rregullim i pasaktë i normës ligjore, që i lë shteg zbatuesit për t'i dhënë asaj kuptime të ndryshme dhe me pasoja, nuk shkon në përputhje me qëllimin, stabilitetin, besueshmërinë dhe efektivitetin që synon vetë norma juridike.

8.3 Ky rregullim juridik i normës së sipërcituar nuk shkon në të njëjtën linjë me unifikimin që Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë u kanë bërë padive që kanë për objekt çështjet e kthimit të pronave.

8.4 Zbatimi i nenit 18 të ligjit rezulton, në fakt, të jetë “shfuqizuar” nga vendimi nr. 4, datë 10.12.2013 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë (vendimi nr. 4/2013). Me këtë vendim, i cili është i detyrueshëm për t'u zbatuar nga gjykatat, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë unifikuar qëndrimin e tyre, duke vlerësuar se *“kur në objektin e gjykimit kundërshtohet vendimi i KKKP-së apo AKKP-së, kjo çështje do të konsiderohet si mosmarrëveshje civile dhe do të shqyrtohet nga gjykata që ka kompetencë gjykimin e mosmarrëveshjeve civile.”*

8.5 Kolegjet e Bashkuara, me zgjidhjen e dhënë, i kanë hequr kompetencën kësaj gjykate, duke e dërguar shqyrtimin e çështjes në gjykatën e vendit ku ndodhet prona.

8.6 Në një kohë që vendimi i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë i konsideron çështjet me objekt kundërshtimin e vendimit të AKKP-së, si mosmarrëveshje civile dhe jo si mosmarrëveshje administrative, Gjykata

Kushtetuese ka pranuar se AKKP-ja dhe drejtori i saj, është një organ administrativ, në dallim nga KKKP-ja, që nuk është e tillë.

9. **Subjektet e interesuara dhe Këshilli i Ministrave**, në parashtrimet e tyre me shkrim drejtuar Gjykatës, kanë prapësuar sa më poshtë:

9.1 Gjykata referuese nuk ka arritur t'i ngrejë kërkimet e saj në nivelin e parashtrimit të arsyeve serioze për jokushtetueshmërinë e normës së kundërshtuar.

9.2 Gjykata referuese ka shmangur haptazi dispozitat që e lejonin atë të zgjidhte çështjen në themelin e saj. Për më tepër, gjykata referuese nuk ka bërë asnjë tentativë për të interpretuar dispozitën në përputhje me Kushtetutën. Ajo nuk ka asnjë pengesë për ta zgjidhur çështjen e pikërisht për këtë arsye kjo kërkesë duhet të rrëzohet.

9.3 Neni 18 i ligjit nr. 9235/2004 dhe vendimi unifikues nr. 4/2013 janë në harmoni me njëri - tjetrin jo vetëm në kuptim të garantimit të të drejtave kushtetuese të subjekteve të parashikuara dhe thelbit të tyre, por sepse garantojnë edhe mjetet e duhura për gjykatat e juridiksionit të zakonshëm për të zgjidhur konfliktet, siç është ai objekt gjykimi në gjykatën referuese. Në këtë kuptim, siguria juridike është e garantuar.

9.4 Gjykata referuese nuk ka arritur të sjellë argumente të mjaftueshme për të ngritur në nivel kushtetues objektin e kërimit, duke e bërë këtë të fundit të papranueshëm.

Vlerësimi i Gjykatës

III

10. Kërkesa për kontroll incidental të normës ligjore, që përbën mjetin e aksesit të gjykatës së juridiksionit të zakonshëm në gjykimin kushtetues, rregullohet nga neni 145/2 i Kushtetutës, sipas të cilit, kur gjyqtarët çmojnë se ligjet janë në kundërshtim me Kushtetutën, nuk i zbatojnë ato, por pezullojnë gjykimin dhe ia dërgojnë çështjen kësaj Gjykate për t'u shprehur në lidhje me kushtetueshmërinë e saj. Në zbatim të kësaj dispozite kushtetuese, neni 68 i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” përcakton disa kushte, të cilat duhet të respektohen nga gjykata referuese për të iniciuar gjykimin incidental: së pari, gjatë një procesi gjyqësor ajo duhet të përcaktojë/identifikojë ligjin që zbatohet për zgjidhjen e çështjes konkrete (lidhjen e



drejtpërdrejtë) dhe, së dyti, duhet të parashtrijë arsye serioze për jokushtetueshmërinë e ligjit ose dispozitave të tij, duke referuar në normat ose parimet konkrete të Kushtetutës. Gjykata Kushtetuese (Gjykata) ka theksuar, gjithashtu, se para marrjes së vendimit të pezullimit të çështjes, gjykata referuese duhet të konkludojë se gjykimi që ka nisur nuk mund të përfundojë pa i dhënë përgjigje çështjes së kushtetueshmërisë së ligjit nga ana e Gjykatës Kushtetuese. (*shih vendimet nr. 5, datë 06.03.2009; nr. 13, datë 04.05.2009 dhe nr. 30, datë 17.06.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Gjykata ka theksuar se objekti dhe shkaqet e kërkesës me të cilat ngrihet çështja e kushtetueshmërisë përbëjnë thelbin (*thema decidendum*) e gjykimit kushtetues. Në këtë kuptim, Gjykata vëren se në objekt të kërkesës gjykata referuese ka kërkuar shfuqizimin si jokushtetues të nenit 18 të ligjit nr. 9235/2004, kurse referuar shkaqeve të kërkesës rezulton se ajo kërkon zgjidhjen e konfliktit ligjor midis vendimit unifikues nr. 4/2013 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe normës së kundërshtuar, pasi, sipas saj, zbatimi i tij, i cili kundërshton këtë unifikim të ligjit nga Gjykata e Lartë, cenon standardin e sigurisë juridike, për shkak të paqartësisë së normës juridike, por edhe të pranisë së kontradiksionit me normat e tjera ligjore që zbatohen në çështjen e kthimit të pronave. Pra, në thelb, gjykata referuese ngre pretendime në lidhje me pajtueshmërinë me këto parime kushtetuese të nenit 18 të ligjit nr. 9235/2004 të pretenduar si antikushtetues.

12. Gjykata ka vlerësuar se siguria juridike, mbrojtja e të drejtave të fituara, si dhe e pritshmërive të ligjshme, si standarde kushtetuese të trajtuara vazhdimisht nga jurisprudenca kushtetuese, përbëjnë elemente të parimit të shtetit të së drejtës, të sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës. Parimi i sigurisë juridike, përfshin, krahas qartësisë, kuptueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së sistemit normativ, edhe besimin te sistemi juridik, pa marrë përsipër garantimin e çdo pritshmërie për mosndryshim të një situate të favorshme ligjore. Besueshmëria ka të bëjë me bindjen e individit se nuk duhet të shqetësohet vazhdimisht ose të jetojë me frikë për ndryshueshmërinë dhe pasojat negative të akteve juridike, të cilat mund të cenojnë jetën e tij private ose profesionale dhe të përkeqësojnë një gjendje të vendosur me akte të mëparshme (*shih vendimet nr.*

34, datë 20.12.2005; nr. 9, datë 26.02.2007; nr. 4, datë 12.02.2010 dhe nr. 24, datë 12.11.2008 të Gjykatës Kushtetuese).

13. Parimi i sigurisë juridike kërkon domosdoshmërisht një formulim të qartë të normave ligjore, pasi një rregullim i pasaktë i normës ligjore, që i lë shteg zbatuesit për t'i dhënë asaj kuptime të ndryshme dhe me pasoja, nuk shkon në përputhje me qëllimin, stabilitetin, besueshmërinë dhe efektivitetin që synon vetë norma juridike. Është kërkesë e parimit të sigurisë juridike fakti se një ligj në tërësi, pjesë apo dispozita të veçanta të tij në përmbajtjen e tyre duhet të jenë të qarta, të përcaktuara dhe të kuptueshme. Prandaj është detyrë e gjykatave ose organeve të tjera shtetërore e shoqërore, të ngarkuara me ligj, që mangësi të caktuar të një ligji t'i plotësojnë natyrshëm përmes interpretimit dhe zbatimit të tij në praktikë. Por që të realizohet një gjë e tillë, para së gjithash ligji duhet kuptuar saktë dhe drejtë. Prandaj duhet të dalë qartë qëllimi i hartimit të tij. Ai duhet të përcaktojë mjetet e ndërhyrjes, subjektet të cilave u drejtohet, raportet e caktuara të sjelljes dhe mënyrën e zbatimit të tij. Rezultati që synohet duhet të jetë i pritshëm dhe pasojat të parashikueshme për subjektet të cilave u drejtohet ligji në tërësi ose dispozita të veçanta të tij (*shih vendimet nr. 34, datë 20.12.2005 dhe nr. 31, datë 19.11.2003 të Gjykatës Kushtetuese*). Për të zbatuar drejt këtë parim kërkohet, nga njëra anë, që ligji në një shoqëri të ofrojë siguri, qartësi dhe vazhdimësi, në mënyrë që individët t'i drejtojnë veprimet e tyre në mënyrë korrekte e në përputhje me të, dhe, nga ana tjetër, të mos qëndrojnë statik nëse duhet t'i japë formë një koncepti, siç është ai i drejtësisë në një shoqëri që ndryshon me shpejtësi (*shih vendimin nr. 36, datë 15.10.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Gjykata vlerëson se në rastin në shqyrtim gjykata referuese nuk ka ngritur në nivel kushtetuese pretendimet se normat kanë paqartësi, duke mos mundur të justifikojë, në këtë mënyrë, pretendimin për papajtueshmërinë me Kushtetutën të nenit 18 të ligjit nr. 9235/2004, të kundërshtuar. Përkundrazi, pretendimet e gjykatës referuese bazohen në argumentet se mes normës së kundërshtuar dhe vendimit unifikues të Gjykatës së Lartë ka një mospërputhje dhe se, sipas saj, neni 18 bie në kundërshtim me mënyrën se si është unifikuar ligji nga Gjykata e Lartë, si edhe se ka një kontradiksion mes normës së kundërshtuar dhe



normave të tjera ligjore që zbatohen në çështjen e kthimit të pronave.

15. Në lidhje me pretendimin për përplasje mes normave ligjore në fuqi, Gjykata vlerëson se bazuar në nenin 131 të Kushtetutës në juridiksionin e saj hyjnë papajtueshmëria e ligjeve dhe akteve normative të organeve qendrore dhe vendore me Kushtetutën. Gjykata ka theksuar se nuk është detyrë e saj shqyrtimi i përplasjeve dhe papajtueshmërive mes dy ligjeve të ndryshme apo ligjeve dhe kodeve. Mënyra e të kuptuarit, e të zbatuarit të ligjit dhe e harmonizimit ndërmjet dispozitave të tij me ligje të tjera nuk janë çështje që i përkasin kontrollit kushtetues dhe, për rrjedhojë, nuk janë objekt shqyrtimi nga Gjykata Kushtetuese (*shih vendimet nr. 11, datë 27.05.2004; nr. 35, datë 10.10.2007 dhe nr. 2, datë 03.02.2010 Gjykatës Kushtetuese*).

16. Për sa u përket pretendimeve që lidhen me përplasjet që ka norma e kundërshtuar me vendimin unifikues, Gjykata ka theksuar se interpretimi i ligjeve është kompetencë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm dhe sidomos e Gjykatës së Lartë. Në këtë kuptim, Kushtetuta i ka dhënë Gjykatës së Lartë autoritetin të njësojë ose ndryshojë praktikën gjyqësore, pra të mbajë qëndrime në çështje të veçanta, me qëllim unifikimin e vendimmarrjes së gjykatave të zakonshme. Ky funksion ushtrohet nga Gjykata e Lartë duke tërhequr për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara çështje të caktuara. Kjo vjen si pasojë e pozicionit të saj si organi më i lartë i sistemit gjyqësor dhe lidhet me funksionin e përgjithshëm të saj për të siguruar uniformitetin e interpretimit të normave ligjore nga ana e gjyqtarëve të zakonshëm, përmes përcaktimit të linjave të interpretimit, të cilave gjyqtarët duhet t'u përmbahen (*shih vendimin nr. 6, datë 17.02.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Gjykata vëren se ndërsa norma ligjore e kundërshtuar rregullon çështjen e aksesit në gjykatë dhe afatin ligjor për të kundërshtuar vendimet e AKKP-së, vendimi unifikues ka rregulluar çështjen e kompetencës lëndore në disa raste të caktuara. Edhe pse ligji ka përcaktuar si gjykatë kompetente në raste të tilla Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ndërkohë që vendimi unifikues ka përcaktuar si të tillë gjykatën që ka kompetencën të gjykojë në themel mosmarrëveshjen civile, nuk është argument i mjaftueshëm për të vënë në dyshim kushtetueshmërinë e normës. Gjykata vlerëson,

gjithashtu, se gjykata që zgjidh çështjen ka të gjithë hapësirën e nevojshme që t'u referohet normave ligjore në fuqi për zgjidhjen e çështjes, më konkretisht dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurës Civile.

18. Në bazë të nenit 145 të Kushtetutës, gjyqtarët i nënshtrohen Kushtetutës dhe ligjeve, duke respektuar hierarkinë e burimeve të së drejtës. Bazuar në nenin 116 të Kushtetutës, marrëdhëniet midis normave juridike bazohen në raportin e mbi/nënvendosjes së tyre. Rendi juridik nuk është një radhitje e barasvlershme normash, por një sistem hierarkik, i cili përbëhet nga nivele të ndryshme vlefshmërie dhe në secilin prej këtyre niveleve qëndron një normë ose grup normash, duke përfutur kështu edhe fuqinë e caktuar juridike. Kjo piramidë aktesh normative ka në majë të saj Kushtetutën, e cila shërben si burim për aktet e tjera juridike (*shih vendimin nr. 3, datë 20.02.2006 të Gjykatës Kushtetuese*). Respektimi i hierarkisë së akteve normative është një detyrim që rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës dhe i koherencës në sistemin ligjor (*shih vendimin nr. 2, datë 03.02.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Gjykata konfirmon qëndrimin e saj se një çështje nuk hyn në sferën e kompetencës së Gjykatës nëse paraqet probleme apo kërkon vlerësime lidhur me vendosjen respektive hierarkike të normave në konflikt, të cilat si të tilla hyjnë në sferën e kompetencës së gjykatës referuese (*shih vendimin nr. 6, datë 17.02.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se në rastin konkret, gjykata referuese, në thelb, i kërkon Gjykatës të përcaktojë se cili do të jetë ligji i zbatueshëm prej saj në çështjen konkrete në shqyrtim, çka është një çështje që nuk i përket juridiksionit kushtetues, por juridiksionit të zakonshëm gjyqësor, më konkretisht vetë kësaj gjykate, në zbatim të parimeve të përgjithshme të së drejtës.

20. Në përfundim, Gjykata rithekson se në vlerësimin e kushtetueshmërisë së ligjeve, ajo nisat nga prezumimi i pajtueshmërisë së tyre me Kushtetutën. Kjo do të thotë se lidhur me antikushtetueshmërinë e pretenduar duhet të parashtrihen argumente bindëse për t'i dhënë mundësi kësaj Gjykate të vlerësojë nëse zgjidhjet ligjore të zbatuara shkelin normat dhe vlerat kushtetuese. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se gjykata referuese nuk ka arritur të paraqesë



argumente bindëse për të mbështetur kërkesën e saj dhe, për pasojë, kërkesa është e pabazuar e duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, shkronja “a”; 134, pika 1, shkronja “d” dhe 145 pika 2 të Kushtetutës, si dhe të neneve 68, 69, 70, 72 e vijues të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha, Besnik Imeraj, Fatos Lulo, Gani Dizdari.

URDHËR

Nr. 58/1, datë 22.1.2015

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË URDHRIN NR. 58, DATË 21.8.2014 “PËR MIRATIMIN E FORMATEVE STANDARD PËR DOKUMENTIMIN E VEPRIMTARISË SË INSPEKTIMIT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Në zbatim të nenit 16, pika 2, shkronja c të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Në formatin standard nr. 1 “Autorizim inspektimi”, bëhet ndryshimi si më poshtë:

Fjalja “Njoftimi paraprak i autorizimit nuk njoftohet për arsye: (neni 27 pika 2, germa “a”/“b” gjenerohet nga sistemi), bëhet “Njoftimi paraprak i autorizimit nuk njoftohet për arsye: (neni 32 pika 2, shkronja “a”-“d”, gjenerohet nga sistemi. Në rastin e shkronjës “a”, vendimi i mosnjoftimit paraprak motivohet, ndërsa në rastin e shkronjës “b”, evidentohet përcaktimi i ligjit të posaçëm që lejon mosnjoftimin paraprak të inspektimit”).

2. Në formatin standard nr. 2 “Procesverbal

inspektimi” dhe në formatin standard nr. 3 “Procesverbal inspektimi (i posaçëm)”, në kreun III bëhet ndryshimi si më poshtë:

Fjalja “Bashkëlidhur listë-verifikimi i plotësuar gjatë inspektimit” bëhet “Bashkëlidhur fletë shoqëruese për këshillimin me shkrim të subjektit për mënyrën e korrigjimit të shkeljeve”.

3. Në formatin standard nr. 2 “Procesverbal inspektimi” dhe në formatin standard nr. 3 “Procesverbal inspektimi (i posaçëm)”, në fund të kreut III shtohet fjalia “Bashkëlidhur dokumente që inspektori i gjykon të nevojshme për procesin e inspektimit”.

4. Në formatin standard nr. 2 “Procesverbal inspektimi”, pas pikës 7 të kreut II “Procedura e inspektimit” shtohet pika 7/1 dhe në formatin standard nr. 3 “Procesverbal inspektimi (i posaçëm)”, pas pikës 1 të kreut II “Procedura e inspektimit” shtohet pika 1/1, të titulluara “Gjetjet e konstatuara për zbatimin e ligjit nr. 76/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9636, datë 6.11.2006, “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”, të ndryshuar, si dhe fjalia “Bashkëlidhur listë verifikimi për zbatimin e ligjit nr. 76/2014, i plotësuar gjatë inspektimit”.

5. Të shtohet formati standard nr. 2/1 “Procesverbal inspektimi (aty për aty)”, i cili përdoret në ato fusha inspektimi që e kanë të nevojshme për dokumentimin e procedurës për marrjen e masës urgjente.

6. Në formatin standard nr. 11 “Vendimi i Komisionit të Ankimit”, në fund shtohet fjalia “Kundër vendimit të Komisionit të Ankimit mund të bëhet ankim në gjykatë sipas ligjit”.

7. Formatet standard për dokumentimin e veprimtarisë së inspektimit nr. 1, nr. 2, nr. 2/1, nr. 3 dhe nr. 11 bëhen sipas formateve standard të aneksit që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

8. Ngarkohen Inspektorati Qendror dhe Inspektoratet Shtetërore për zbatimin e këtij urdhri.

9. Ky urdhër publikohet në Faqen Zyrtare të Inspektoratit Qendror,
www.inspektoratiqendror.gov.al,
si dhe iu njoftohet Inspektoratëve Shtetërore.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**INSPEKTOR I PËRGJITHSHËM
Ilir Zela**



**FORMATET STANDARD PËR DOKUMENTIMIN E VEPRIMTARISË
SË INSPEKTIMIT – Aneks**

Formati Nr. 1

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA XXX
INSPEKTORATI SHTETËROR XXX
DEGA RAJONALE E QARKUT _____

AUTORIZIM INSPEKTIMI

Nr. III/00000007/A

Datë ____ / ____ / ____

Bazuar në nenin 27 të Ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe VKM për krijimin e inspektoratit shtetëror përkatës autorizoj inspektimin e

Të dhëna mbi subjektin e inspektimit:

Emri i subjektit: _____ NIPT: _____

Adresa/vendndodhja: _____

Përshkrim i objektit të inspektimit: *(Sigurimi dhe zbatimi i dispozitave ligjore.....)*

Inspektorët shtetëror të autorizuar për të kryer inspektimin:

1. _____ ID: _____

2. _____ ID: _____

si dhe persona të tjerë të autorizuar;

1. _____ ID: _____

2. _____ ID: _____

Kohëzgjatja e inspektimit: _____
*(Me selektim në sistem: 1/2, 1 e 1/2 - 15 ditë)*_____
*(ora, data e fillimit)*_____
(ora, data e përfundimit)

Vendi/vendet ku do të kryehet inspektimi (adresa/t): _____

Njoftim paraprak i autorizimit subjektit të inspektimit: Po ☐ Jo ☐

Njoftimi paraprak i autorizimit nuk njoftohet për arsye: (neni 32 pika 2, shkronja a-d, gjenerohet nga sistemi. Në rastin e shkronjës a-, vendimi i mosnjoftimit paraprak motivohet, ndërsa në rastin e shkronjës b-, evidentohet përcaktimi i ligjit të posaçëm që lejon mosnjoftimin paraprak të inspektimit)” _____

KRYINSPEKTORI
(sipas VKM për krijimin e ISH)

Nënshkrimi, Vula e institucionit



Formati Nr. 2



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA XXX
INSPEKTORATI SHTETËROR XXX

DEGA RAJONALE E QARKUT _____

PROCESVERBAL INSPEKTIMI

Nr. III/00000007/PV

Datë ____/____/____/

Bazuar në nenin 45 të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

I. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME:

Emri i subjektit: _____ NIPT: _____

Adresa/vendndodhja: _____

Emri i Punëdhënësit: _____

Kohëzgjatja e inspektimit në vendin e inspektimit: *(gjenerohen nga sistemi, autorizimi)*_____
*(ora, data e fillimit)*_____
(ora, data e përfundimit)

Vendi/vendet e inspektimit (adresa/t): _____

Njoftim paraprak lënë subjektit :

Po ☐ Jo ☐

Inspektim me autorizim:

Po ☐ Jo ☐*(N.q.s. jo, do zgjidhet nga sistemi një nga gjerat e nenit 27 pika 2 të ligjit 10 443)*

Lloji i autorizimit: autorizim i afishuar:

Po ☐ Jo ☐**Hyrja dhe inspektimi forcërisht në prani të punonjësit të Policisë së Shtetit:**Po ☐ Jo ☐*(N.q.s Po të plotësohet si më poshtë arsyetimi sipas ligjit të posaçëm për policinë e shtetit dhe të ketë hapësirë për ngarkim dokumenti shpenzimi)*

Përfashtimi i përfaqësuesit të subjektit të inspektimit:Po ☐ Jo ☐*(Nqs Po të plotësohet si më poshtë)*

Arsyetimi i përfashtimit:

Procesverbali mbahet në tre kopje dhe nënshkruhet nga inspektorët që e mbajnë atë.



Masa urgjente:

Po ☐ Jo ☐

(Nqs Po të plotësohet si më poshtë dhe hapësirë për ngarkimin e vendimit të ndërmjetëm në sistem)

II. PROCEDURA E INSPEKTIMIT

1. Mostra të marra:

Po ☐ Jo ☐

(nqs Po më poshtë do të gjenerohet nga sistemi tabelat e mëposhtme në varësi të Inspektorit Shtetëror përkatës)

TABELA E MARRJES SË MOSTRAVE

TABELA (për kryerjen e ekspertizave të tjera të nevojshme për verifikimin e produkteve, pajisjeve, proceseve apo makinerive)

2. Dokumente të marra:

Nr.	DOKUMENTI I MARË DHE PËRSHKRIMI	NR. FLETËVE
1		
2		

3. Vendim për sekuestrim dokumentacioni: (ngarkohet në sistem)

Nr.	DOKUMENTI I SEKUESTRUAR DHE PËRSHKRIMI	NR. FLETËVE
1		
2		

4. Detyra të parealizuara nga inspektimi i mëparshëm:

5. Detyrimi i subjektit për paraqitje në zyrën e inspektorit

Po ☐ Jo ☐

(Nenin 33, Pikat 1/b, dhe 2 të ligjit nr. 10 433, datë 16.06.2011 "Për Inspektimin në RSH", si dhe parashikimet të ligjit të veçantë)

Përfaqësuesi i autorizuar i subjektit _____, më date ____/____/____; ora _____ të paraqitet në adresën: _____ për vazhdimin e procedurës së inspektimit.

Procesverballi mbahet në tre kopje dhe nënshkruhet nga inspektorët që e mbajnë atë.

**6. Dokumentacioni dhe sendet që duhet të paraqesni:****Dokumente të paraqitura:**

Nr.	DOKUMENTI DHE PËRSHKRIMI	NR. FLETËVE
1		
2		

Sende të paraqitura:

Nr.	SENDI DHE PËRSHKRIMI	COPE
1		
2		

Mosparaqitja do të konsiderohet pengim në kryerjen e detyrës së Inspektorit Shtetëror referuar nenit 54, të ligjit 10433, datë 16.06.2011, “Për Inspektimin në RSH”.

7. Gjetjet e konstatuara

Ka shkelje të kërkesave ligjore:

Po ☐

Jo ☐

(Nqs Jo, ky procesverbal konsiderohet edhe si vendim përfundimtar)

(Nqs po të plotësohet si më poshtë)

Gjetjet e konstatuara në këtë procesverbal bien në kundërshtim me kërkesat ligjore të parashikuara në nenin/et e ligjit/ve:

7/1. Gjetjet e konstatuara për zbatimin e ligjit nr. 76/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 9636, datë 6.11.2006, “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”, i ndryshuar.

Po ☐

Jo ☐

Bashkëlidhur listë verifikimi për zbatimin e ligjit nr. 76/2014, i plotësuar gjatë inspektimit.

8. Njoftimi i procesverbalit të subjektit të inspektimit

Për faktet dhe rrethanat e konstatuara të paraqitura në këtë procesverbal, subjekti mund të paraqesë shpjegimet apo kontestimet e tij me shkrim ose me gojë pranë Inspektoratit Shtetëror, brenda __ ditëve nga data e njoftimit të këtij procesverbali.

Me përfundimin e këtij afati, do të merret vendimi përfundimtar i inspektimit.

Bashkëlidhur listë verifikimi i plotësuar gjatë inspektimit.

Procesverbali mbahet në tre kopje dhe nënshkruhet nga inspektorët që e mbajnë atë.



9. Në rast se nuk konstatohen shkelje të jepen arsyet e përfundimit të procedimit.

III. KUNDRAVAJTJET ADMINISTRATIVE

Për shkak të shkeljeve të konstatuara të kërkesave ligjore të subjektit të inspektimit, në mbështetje të ligjit nr. ___ datë ___/___/___/ nenit/eve ___ ato klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe parashikohen dënimet administrative si më poshtë:

1. Dënim administrativ kryesor:

- a. _____;
b. _____;

2. Dënim administrativ plotësues:

- a. _____;
b. _____;
c. _____;

Shkeljet e kërkesave ligjore për t'u korrigjuar:

Bashkëlidhur fletë shoqëruese për këshillimin me shkrim të subjektit për mënyrën e korrigjimit të shkeljeve.

Bashkëlidhur dokumente që inspektori i gjykon të nevojshme për procesin e inspektimit.

IV. VENDIMI PËRFUNDIMTAR

Vendim përfundimtar i veçantë

Po ☐

Jo ☐

Nëse Po Vendimi përfundimtar ngarkohet në sistem.

Nëse Jo Vendimi përfundimtar kur nuk janë konstatuar shkelje ligjore, pasqyrohet më poshtë:

V. FORMALIZIMI

Ky procesverbal u mbajt sot më datën ___/___/___/ dhe pasi lexohet nënshkruhet si më poshtë:

Inspektori/ët Shtetëror

Personi i autorizuar nga subjekti

Procesverbal i njoftohet subjektit brenda 5 ditëve nga data e përfundimit të inspektimit.

Procesverbal mbahet në tre kopje dhe nënshkruhet nga inspektorët që e mbajnë atë.



Formati Nr. 2/1



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA XXX
INSPEKTORATI SHTETËROR XXX

DEGA RAJONALE E QARKUT _____

PROCESVERBAL INSPEKTIMI (aty për aty)

Nr. III/00000007/PV

Datë __/__/__

Bazuar në nenin 45 të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

I. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME:

Emri i subjektit: _____ NIPT: _____

Adresa/vendndodhja: _____

Emri i Punëdhënësit: _____

Masa urgjente:

1. Gjetjet e konstatuara në lidhje me masën urgjente

Ka shkelje të kërkesave ligjore:

Gjetjet e konstatuara në këtë procesverbal bien në kundërshtim me kërkesat ligjore të parashikuara në nenin/et e ligjit/ve:

2. Njoftimi i procesverbalit (aty për aty) subjektit të inspektimit

Faktet dhe rrethanat e konstatuara të njoftuara subjektit me qëllimin e marrjes së masës urgjente:

Procesverbali mbahet në tre kopje dhe nënshkruhet nga inspektorët që e mbajnë atë.



Subjekti i inspektimit mund të paraqesë shpjegimet apo kontestimet përkatëse:

II. FORMALIZIMI

Ky procesverbal u mbajt sot më datën __/__/____/ dhe pasi lexohet nënshkruhet si më poshtë:

Inspektori/ët Shtetëror

Personi i autorizuar nga subjekti

Procesverbali mbahet në tre kopje dhe nënshkruhet nga inspektorët që e mbajnë atë.



Formati Nr. 3



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA XXX
INSPEKTORATI SHTETËROR XXX

DEGA RAJONALE E QARKUT _____

PROCESVERBAL INSPEKTIMI
(I POSAÇËM)

Nr. III/00000007/PV

Datë ____/____/____/

Bazuar në nenin 45 të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

I. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME:

Emri i subjektit: _____ NIPT: _____

Adresa/vendndodhja: _____

Emri i Punëdhënësit: _____

Kohëzgjatja e inspektimit në vendin e inspektimit: (gjenerohen nga sistemi, autorizimi)

(ora, data e fillimit)

(ora, data e përfundimit)

Vendi/vendet e inspektimit (adresa/t): _____

Inspektim me autorizim të posaçëm: Po ☐ Jo ☐

(N.q.s. po, do zgjidhet nga sistemi një nga germat, a ose b, të nenit 27 pika 2 të ligjit 10 443)

Lloji i autorizimit: autorizim i afishuar: Po ☐ Jo ☐

Hyrja dhe inspektimi forcërisht në prani të punonjësit të Policisë së Shtetit:

Po ☐ Jo ☐

(N.q.s Po të plotësohet si më poshtë arsyetimi edhe sipas ligjit të posaçëm për policinë e shtetit, si dhe të ketë hapësirë për ngarkim të dokumentit të shpenzimeve)

Përjashtimi i përfaqësuesit të subjektit të inspektimit:

Po ☐ Jo ☐

(Nqs Po të plotësohet si më poshtë)



Arsyetimi i përjashtimit:

II. PROCEDURA E INSPEKTIMIT

1. Gjetjet e konstatuara gjatë këtij inspektimi ;

Ka shkelje të kërkesave ligjore:

Po ☐

Jo ☐

(Nqs Po të plotësohet si më poshtë)

Gjetjet e konstatuara në këtë procesverbal bien në kundërshtim me kërkesat ligjore të parashikuara në nenin/et e ligjit/ve :

7/1. Gjetjet e konstatuara për zbatimin e ligjit nr. 76/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 9636, datë 6.11.2006, “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”, i ndryshuar.

Po ☐

Jo ☐

Bashkëlidhur listë verifikimi për zbatimin e ligjit nr. 76/2014, i plotësuar gjatë inspektimit.

2. Masa urgjente:

Po ☐

Jo ☐

(Nqs po të plotësohet më poshtë dhe hapësirë për ngarkimin e vendimit të ndërmjetëm)

3. Detyra të parealizuara nga inspektimi i mëparshëm:

4. Shpjegime dhe kontestime të subjektit për faktet dhe rrethanat e konstatuara:

Grupi i punës, pasi realizoi inspektimin, hartoi procesverbalin e inspektimit dhe ia njoftoi atë subjektit të inspektimit. Subjekti i inspektimit pati kontestimet si më poshtë vijon:

Dokumentat e paraqitura nga subjekti ngarkohen në sistem

5. Shkelje të kërkesave ligjore:

Në bazë të procesverbalit të inspektimit dhe kontestimeve të subjektit të inspektimit rezultuan këto shkelje të kërkesave ligjore, *(emërtesa e ligjit, nenit, pikës, germës):*

Procesverballi mbahet në tri kopje dhe nënshkruhet nga inspektorët që e mbajnë atë.



III. KUNDRAVAJTJET ADMINISTRATIVE

Për shkak të shkeljeve të konstatuara të kërkesave ligjore të subjektit të inspektimit, në mbështetje të ligjit nr. ____ datë ____/____/____/ nenit/eve ____ ato klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe parashikohen dënimet administrative si më poshtë:

1. Dënim administrativ kryesor:
 - a. _____;
 - b. _____;
2. Dënim administrativ plotësues:
 - a. _____;
 - b. _____;
 - c. _____;

Shkeljet e kërkesave ligjore për t'u korrigjuar:

Bashkëlidhur fletë shoqëruese për këshillimin me shkrim të subjektit për mënyrën e korrigjimit të shkeljeve.

Bashkëlidhur dokumente që inspektori i gjykon të nevojshme për procesin e inspektimit.

IV. VENDIMI PËRFUNDIMTAR

1. Vendimi përfundimtar në rastet e marrjes aty për aty, në përfundim të inspektimit *(sipas parashikimeve të ligjit të posaçëm)*

V. FORMALIZIMI

Ky procesverbal u mbajt sot më datën ____/____/____/ dhe pasi lexohet nënshkruhet si më poshtë:

Inspektori/ët Shtetëror

Personi i autorizuar nga subjekti

1. _____ ID: _____

2. _____ ID: _____

Procesverbali mbahet në tri kopje dhe nënshkruhet nga inspektorët që e mbajnë atë.



Formati Nr. 11



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA XXX
INSPEKTORATI SHTETËROR XXX

DEGA RAJONALE E QARKUT _____

VENDIMI

I KOMISIONIT TË ANKIMIT

Nr. III/00000007/VP

Datë ____/____/____

Emërtimi i Komisionit të Ankimit _____
(Emërtimi i inspektoratit shtetëror)

Emri i subjektit që është ankuar të cilit i referohet vendimi përfundimtar *(kjo pjesa plotësohet nga sistemi)*

Në bazë të pikës 2 të nenit 51 të ligjit 10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe Ankimit për vendimin përfundimtar nr. _____, datë ____/____/____, i subjektit _____ (emërtimi i subjektit që është ankuar), *(kjo pjesa plotësohet nga sistemi)*

Pasi shqyrtoi ankesën e këtij subjekti dhe masën administrative të marrë *(Shpjegimi i fakteve që janë bërë shkak për vendosje të dënimit administrativ)*, Komisionit i ankimit:

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit përfundimtar dhe rrëzimin e ankimit për vendimin përfundimtar ☐
2. Shfuqizimin e vendimit përfundimtar dhe pranimin e ankimit për vendimin përfundimtar ☐
3. Ndryshimin e vendimit përfundimtar, duke pranuar pjesërisht ankimin për vendimin përfundimtar ☐

Për sa më sipër urdhëroj lënien (nëse zgjidhet opsioni 1) / ndërprerjen (nëse zgjidhet opsioni 2) / ndryshimin (nëse zgjidhet opsioni 3) të masës urgjente përkatëse, *(gjenerohet nga sistemi masa e marrë)*.

KRYINSPEKTORI
(sipas VKM për krijimin e ISH)

Nënshkrimi, Vula e institucionit

Kundër Vendimit të Komisionit të Ankimit mund të bëhet ankim në gjykatë sipas ligjit



KËRKESË
Nr. 835, datë 5.2.2015

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Unaza Veriore Korçë”.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur, në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe përllogaritjes së masës së shpërblimit për pasuritë pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen titullin e pronësisë, apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës).

Ky publikim bëhet për pasurinë e llojit, “truall”.

Pronarët do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”).

Vlera totale e shpronësimit është 9 270 720 (nëntë milionë e dyqind e shtatëdhjetë mijë e shtatëqind e njëzet) lekë.

MINISTRI I TRANSPORTIT DHE
INFRASTRUKTURËS
Edmond Haxhinasto

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI SHPRONËSIMEVE

Lista e pronarëve që shpronësohen nga ndërtimi i segmentit “Unaza Veriore Korçë” (Varrezat e qytetit-Kryqëzimi Ersekës)

Nr.	Pronari			ZK	Nr. Pasurisë	Lloji i pasurisë						VLERA TOTALE (Lek)	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri			Truall			Arë				
						Sip. m2	Cmimi m2	Vlera në lek	Sip. m2	Cmi mi m2	Vlera në lek		
1	Adriatik	Egerem	Hasanllari	8563	4/189	44	9280	408,320				408,320	Konfirmuar nga ZVRPP
2	Ardi	Fejzo	Fezga	8563	3/607	19	9280	176,320				176,320	Konfirmuar nga ZVRPP
3	Gezim	Hysen	Shahinllari	8563	3/113	45	9280	417,600				417,600	Konfirmuar nga ZVRPP
4	Vangjel	Kristo	Zharkolli	8563	2/89	56	9280	519,680				519,680	Konfirmuar nga ZVRPP
5	Rita	Aleks	Zhidro	8563	2/201	17	9280	157,760				157,760	Konfirmuar nga ZVRPP
6	Rita	Aleks	Zhidro	8563	2/200	27	9280	250,560				250,560	Konfirmuar nga ZVRPP
7	Nevrus	Xhenali	Rusi	8563	2/95	18	9280	167,040				167,040	Konfirmuar nga ZVRPP
8	Pasho	Demirali	Dymishllari	8563	2/96	22	9280	204,160				204,160	Konfirmuar nga ZVRPP
9	Shkelqim	Hysni	Asabella	8563	2/356	25	9280	232,000				232,000	Konfirmuar nga ZVRPP
10	Jani	Hysni	Asabella	8563	2/260	35	9280	324,800				324,800	Konfirmuar nga ZVRPP
11	Kristaq	Foto	Gusho	8563	2/98	55	9280	510,400				510,400	Konfirmuar nga ZVRPP
12	Pandi	Arqile	Tarusha	8563	2/210	130	9280	1,206,400				1,206,400	Konfirmuar nga ZVRPP
13	Fiqiri	Sami	Vexha+Bp.	8563	2/376	92	9280	853,760				853,760	Konfirmuar nga ZVRPP
14	Vangjel	Lefter	Evangeljeliu	8563	2/136	115	9280	1,067,200				1,067,200	Konfirmuar nga ZVRPP
15	Vangjel	Lefter	Evangeljeliu	8563	2/404	110	9280	1,020,800				1,020,800	Konfirmuar nga ZVRPP
16	Shkelqim	Esat	Vexha+Bp.	8563	2/222	174	9280	1,614,720				1,614,720	Konfirmuar nga ZVRPP
17	Dhimiter	Jorgji	Çipi	8563	2/221	15	9280	139,200				139,200	Konfirmuar nga ZVRPP
TOTALI							999,0	9.270.720				9.270.720	

**KËRKESË****Nr. 836, datë 5.2.2015****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Unaza Veriore Korçë”.

Subjekti kërkuar i këtij objekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur, në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe përlllogaritjes së masës së shpërblimit për pasuritë pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik” të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin

pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen titullin e pronësisë, apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës).

Ky publikim bëhet për pasurinë e llojit “objekt”.

Pronarët do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar (subjekti kërkuar në bazë të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”).

Vlera totale e shpronësimit është 17 511 015 (shtatëmbëdhjetë milionë e pesëqind e njëmbëdhjetë mijë e pesëmbëdhjetë) lekë.

MINISTRI I TRANSPORTIT DHE
INFRASTRUKTURËS
Edmond Haxhinasto

REPUBLIKA E SHQIPERISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONAREVE TË OBJEKTEVE QË PREKEN NGA NDËRTIMI I
SEGMENTIT RRUGOR “UNAZA LINDORE TIRANË” LOTI I (OBJEKTE)

Nr.	Emri - Atësia - Mbiemri	Z.K.	Nr. Pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqe ndërtimi (m2)	Vlera objektit	Vlera Totale (Lekë)	Shënime
1	Mehdi Mustafa Tufa	2529	482/9	Lokal+banesë 2kt	451.2	17511015	17511015	Certifikatë pronësie
SHUMA TOTALE							17511015	

KËRKESË**Nr. 837, datë 5.2.2015****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Levan-Vlorë (shtesat)”.

Subjekti kërkuar i këtij objekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur, në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe përlllogaritjes së masës së shpërblimit për pasuritë pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik” të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.



Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen titullin e pronësisë, apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës).

Ky publikim bëhet për pasurinë e llojit “truall, arë, kullotë, erodive, kultura bujqësore”.

Pronarët do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të

pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar (subjekti kërkuar në bazë të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”).

Vlera totale e shpronësimit është 49 584 759 (dyzet e nëntë milion e pesëqind e tetëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e nëntë) lekë.

MINISTRI I TRANSPORTIT DHE
INFRASTRUKTURËS
Edmond Haxhinasto

REPUBLIKA E SHQIPERISË

Ministria e transportit dhe infrastruktures

MINISTRIA E TRANSPORTIT

Autoriteti Rrugor Shqiptar

SEKTORI SHPRONESIMEVE

LISTA E PRONAREVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR LEVAN-VLORË (shtesat)

NR	PRONARI			Z.Kad	Nr.Pasurise	Sip.Pergj m2	Lloji i Pasurise				Vlefte leke/m2	Kultura bujqesore Vlera ne leke (sipas proceverbalit)	Vlefte totale ne leke	Konfirmimi
	Emri	Atesia	Mbiemri				Truall m2	Are m2	Kullote m2	Erodiva m2				
1	B/P XHEMALI			8605	6/242	210	28				8300		232400	Konfirmuar Z.V.R.P.P
2	PAIDENTIFIKUAR			8605	6/256		180				8300		1494000	Proces konfirmimi
3	PAIDENTIFIKUAR			8605	6/154		4324				8300		35889200	Proces konfirmimi
4	B/P HOXHA			8605	6/155	2700	588				8300		4880400	Konfirmuar Z.V.R.P.P
5	HYSNI		BULLA	1191	21/63	200	200				393		78600	Konfirmuar Z.V.R.P.P
6	ARBEN		ALIAJ	1191	96/24	200	200				393		78600	Konfirmuar Z.V.R.P.P
7	STOLI		BULLA	1191	96/25	450	250				393		98250	Konfirmuar Z.V.R.P.P
8	THYRUAT SAFET	LIKAJ		2838	6/44	3000		1127			281		316687	Konfirmuar Z.V.R.P.P
9	DERVISH		HOXHA	2870	15/2	1700		293			281		82333	Konfirmuar Z.V.R.P.P
10	RRAPI		QARRI	2689	7/55	2338		1976			281		555256	Proces konfirmimi
11	KUJTIM, HABIBE BENDAJ			2870	102/1	1460		431			281	68529	189640	Konfirmuar Z.V.R.P.P
13	VIRJON		HOXHA	2870	32/9	900						47382	47382	Konfirmuar Z.V.R.P.P
14	AMARILDO		PETRITAJ	2765	106	4800		477			281		134037	Konfirmuar Z.V.R.P.P
15	AMARILDO		PETRITAJ	2765	111	4300			2788		197		549236	Konfirmuar Z.V.R.P.P
16	AMARILDO		PETRITAJ	2765	114	6200			3254		197		641038	Konfirmuar Z.V.R.P.P
17	AMARILDO		PETRITAJ	2765	116	5800				5800	197		1142600	Konfirmuar Z.V.R.P.P
18	AMARILDO		PETRITAJ	2765	120	1400				1400	197		275800	Konfirmuar Z.V.R.P.P
19	REDI	RAIT	LLANAJ	1191	2	10000						2144000	2144000	Konfirmuar Z.V.R.P.P
20	MAKSIM		MOLLA	8605	6/264	91	91				8300		755300	Konfirmuar Z.V.R.P.P
	SHUMA					45539	1238	4304	6042	7200			49584759	

KËRKESË

Shtetasja Xhemalie Çaça, e bija e Qerimit dhe e Mihanës, e datëlindjes 10.3.1956, lindur dhe banuese në Synej, Kavajë, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë shpalljen të zhdurur të bashkëshortit të saj, shtetasit Naxhi Çaça.

KËRKUESE
Xhemalie Çaça

KËRKESË

Shtetasi Ferbent Hasantari, i biri e Aliut dhe i Files, i datëlindjes 7.2.1974, lindur dhe banues në Berat, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat shpalljen të zhdurur të vëllait të tij, shtetasit Ilir Hasantari.

KËRKUES
Ferbent Hasantari

KËRKESË

Shtetasja Luçie Ndoci, e bija e Mhillit dhe e Tones, lindur dhe banuese në Shkodër, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër shpalljen të vdekur të shtetasit Dedë Mhill Logu.

KËRKUESE
Luçie Ndoci

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 238 lekë